



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE  
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHËTETIT

**NJOFTIM**

**PËR TESTIMIN E INFORMATIZUAR TË KANDIDATËVE TË KATEGORISË “TROJE” OË KANË  
APLIKUAR NË PROGRAMIN MJEKËSI E PËRGJITHSHME”, VITI AKADEMIK 2023-2024**

Ju bëjmë me dije se në datën 18.09.2023, në orën 12:00 pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA), me adresë: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr. 23, Tiranë (ish-ATSH), do të zhvillohet “Testimi i Informatizuar i kandidatëve të kategorisë *Troje* që kanë aplikuar në programin Mjekësi e Përgjithshme”, viti akademik 2023-2024”.

1. Kandidati duhet të paraqitet pranë QSHA-së 30 minuta përpara orarit të publikuar dhe të jetë i pajisur me:

- Kartë ID ose Pasaportë (dokumenti origjinal);
- Kopje të Kartës ID ose Pasaportës;
- Faturën origjinale të pagesës (me vulën e bankës përkatëse) së tarifës së testimit për llogari të QSHA-së.

Formularin për kryerjen e pagesës mund ta shkarkoni në linkun:

[http://qsha.gov.al/DPSH/materiale/fatura/Fature\\_provim\\_digjitalizuar.pdf](http://qsha.gov.al/DPSH/materiale/fatura/Fature_provim_digjitalizuar.pdf)

***Kandidatët, të cilët nuk paraqesin dokumentet e mësipërme, nuk mund të marrin pjesë në testim.***

2. Kandidati gjatë zhvillimit të testimit duhet të zbatojë rregullat e mëposhtme:

- ndalohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve apo mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të testimit, pasi kjo vlerësohet si kriter mos kualifikimi;
- ndalohet komunikimi me kandidatët e tjerë gjatë zhvillimit të testimit deri në marrjen e deklaratës së rezultatit;
- ndalohet lëvizja përtej vendit të përcaktuar për zhvillimin e testimit;
- ndalohet duhani dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e testimit;
- firmos procesverbalin e pjesëmarrjes dhe rezultatit të marrë.

Të gjithë kandidatët e regjistruar, lutemi të verifikojnë paraprakisht identitetin dhe orarin e pjesëmarrjes në testim, në faqen zyrtare të QSHA-së, në adresën [www.qsha.gov.al](http://www.qsha.gov.al), “Provimet e Shtetit”, rubrika “Njoftime”, “Lista e kandidatëve për testimin e informatizuar të kandidatëve të kategorisë *Troje* që kanë aplikuar në programin Mjekësi e Përgjithshme”, viti akademik 2023-2024”.

**Në lidhje me orarin e pjesëmarrjes në testim, ju bëjmë me dije se orari do të jetë i përcaktuar për çdo kandidat dhe nuk do të ketë ndryshime orari përtej planifikimit të publikuar në faqen zyrtare të QSHA-së.**

*Ju urojmë suksese!*